

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn”


Universiteti POLIS

Ekspertëte vlerësimit të jashtëm:

Dr. Gjergj Thomai



Dr. Elvan Dajko



Janar 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc "Art dhe Dizajn"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IALAplikues:	Universiteti POLIS
2	Fakulteti/Departamenti që e ofron	Departamenti Art dhe Dizajn (Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn), Miratuar me Vendim Senati, Nr. 1 date 12.09.2016
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 406, datë 26.5.2010 Leja e ushtrimit të aktivitetit akademik me Urdhër të MASH nr. 557, date 09.12.2010
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VKA Nr. 470, datë 03.05.2013; Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 250, datë 14.06.2013
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në "Art dhe Dizajn"
6	Cikli i studimit:	Cikli i I
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Nga Institucioni
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
13	Diplomë e përbashkët/Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 6
15	Aktivizimi i programit të studimit	Viti akademik 2010-2011
16	Numri i studentëve aktualë	Viti Akademik 2016-2017 51 studentë Viti Akademik 2017-2018 50 studentë Viti Akademik 2018-2019 51 studentë

Shënim: Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e ASCALqë ndjekin këtë vlerësim.

HYRJJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në “Art dhe Dizajn”

Bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dhe dokumentacionin mbështetës, nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), u konstatua se për licencimin e programit të studimit Bachelor në Art dhe Dizajn ekzistojnë 2 akte, konkretisht:

- Vendim i Këshilli i Ministrave: **VKM** Nr. 406, datë 26.05.2010 “Për hapjen e programeve të reja të studimeve në shkollën e lartë private Universiteti POLIS, Tiranë”
- Urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) **Nr. 557, datë 09.12.2010** “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licencën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit shkollës së lartë Private POLIS”.

Akreditimi i parë për këtë program studimi është kryer në vitin 2013 dhe është finalizuar me aktet e mëposhtme:

- *Urdhër të MASH, Nr. 250, datë 14.06.2013 “Për akreditimin e programeve të studimit që përfundojnë me diplomat universitare “Bachelor”, “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” të Universitetit POLIS”*
- *Vendimin Nr. 470, datë 03.05.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë.*

Programi Bachelor në Art dhe Dizajn është një program i ciklit të parë i cili konsiston në 180 ECTS, dhe ka kohëzgjatje normale tre vjet me kohë të plotë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Dr. Gjergj Thomai

Dr. Elvan Dajko

Koordinator teknik i kësaj procedure ka qenë R. Qatipi, specialiste në ASCAL.

Më datë 15.01.2019 Universiteti POLIS është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për këtë program studimi, nëpërmjet sistemit AMS. Me shkresë Nr. 26 Prot., datë 15.01.2019 “Njoftim për dërgimin e Draft Raportit të vlerësimit të jashtëm”, Draft RVJ është dërguar zyrtarisht.

Universiteti POLIS ka sjellë përgjigje me shkresë Nr. 60/19, datë 18.01.2019 “Komente mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit “Bsc. Art dhe Dizaj”, duke shprehur “vlerësimin për etikën dhe profesionalizmin e GVJ. U_Polis gjykon komentet e shprehura gjatë vizitës së GVJ, si një kontribut i vlefshëm për të përmirësuar më tej cilësinë e programeve të ofruara nga universiteti jonë”.

Pas përgjigjes, Raporti mori formën e tij përfundimtare.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Te krijohen kontakte te vazhdueshme me tregun e punes per permiresime te metejshme programit te studimit.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin e krijimit te kontakteve te vazhdueshme me tregun e punes per permiresime te metejshme programit te studimit ne Bachelor Art dhe Dizajn,eshte krijuar Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK), e cila adreson çështje vetëm për/dhe me syrin e studentit.Në vizionin e U_POLIS që në fillim ka qenë një shkollim me studentin në qendër; kujdesi që tregohet në këtë drejtim, zhvillimet në përmirësim gradual të mësimdhënies, shërbimeve, kujdesit për punësimin e studentëve dhe asistencë ndaj tyre dhe mbështetja e Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK), si njësi e veçantë në funksion dhe për studentin, dëshmon për sa më sipër dhe garanton një zhvillim të mëtejshëm të këtij sistemi. ZMSKK i mbështet studentët në përgatitjen e tyre më të mirë për punësim, në inkurajimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre në fusha të caktuara studimi, gjë që dëshmon për sa më sipër dhe garanton një zhvillim të qëndrueshëm dhe të mëtejshëm të këtij sistemi.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programit Studimit Bachelor në Art dhe Dizajn fokusohet në përgatitjen profesionale të studentëve si Dizajner me mundësi integrimi në një kontekst shumë disiplinor pune, si në sektorin e punësimit privat, ashtu dhe atë publik vendas por dhe më gjerë. Programi i studimit të ciklit të parë ka si qëllim t'i japë një formim bazë e të gjerë në fushën e Arteve Pamore dhe Dizajnit. Qëllimi i Programit të Studimit Bachelor në Art dhe Dizajn është që ti përgatisë studentët profesionalisht si specialist në fushën e Dizajnit me mundësi integrimi në një kontekst ndërdisiplinor pune si në sektorin e punësimit privat ashtu dhe publik. Ky program studimi synon të japë njohuri të përgjithshme bazë mbi artin, zanatet (crafts) dhe dizajnin si pjesë e një sërë veprimtarish formuese të artit të aplikuar, të kombinuara me fusha të tjera krijuese aplikative të cilat sjellin një ngjyrim të ri në këtë formim. Kështu gjatë ciklit të parë të studimeve programi i jep studentëve një formim me bazë të gjerë në art, dhe dizajn; i cili mundëson thellimin e mëtejshëm të tyre gjatë ciklit të dytë të studimeve në fusha specifike të artit të aplikuar dhe dizajnit, apo të ngjashme me to.

Ky program synon të përgatisë ekspertë për tregun e punës në Shqipëri dhe Europë; sikurse edhe studentë të cilët mund të vazhdojnë ciklin e dytë të studimeve në Shqipëri apo në vende të tjera, ose thellimin në programe kërkimore dhe pasuniversitare.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, anekset që i bashkëngjiten këtij raporti, vizitës në terren dhe verifikimit të dokumentacionit rezulton se Programi i studimit Bachelor në Art dhe Dizajn është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit në kuadër të përgatitjes së studentëve profesionalisht si specialist në fushën e Dizajnit me mundësi integrimi në një kontekst ndërdisiplinor pune si në sektorin e punësimit privat ashtu dhe publik. Në të njëjtën kohë të sigurojë një sfond të mjaftueshëm akademik dhe shkencor për të vijuar më tej studimet dhe kërkimin në programet të cikleve të tjera. Programi është hartuar për të përmbushur plotësisht nevojën në tregun e punës në përputhje edhe me nevojat e vendit si dhe mbështetur në eksperiencat ndërkombetare. Politikat dhe objektivat e programit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit në mënyrë që programi të mbështesë zhvillimin e vendit duke përgatitur studentë të aftë
Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	

	për të kontribuar në fushat e specializimit të tyre. Kjo bëhet e mundur edhe nëpërmjet respektimit të Axhendës së Kërkimit Shkencor
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh. në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Permbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e percaktuara nga aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi. Kjo qartësohet nga informacionet e marra në IAL dhe gjatë diskutimeve konsultimit me dokumentacionit perkates.</p> <p>Emertimi i programit të studimit lidhur me nivelin e kualifikimit, sipas diskutimeve me stafin e IAL u informuam se kanë marrë të dhëna nga tregu për mundësi të punësimit të studenteve në nivel kombëtar. IAL raporton një numër gati konstant të studentëve në vite. Nisur nga të dhënat, nga bisedat me zyrën e marketimit, si dhe gjatë takimit me pedagoget e IAL, paraqitet se ky program studimi është i kërkuar dhe ka interes në rritje si ka studentet të cilët aplikojnë në Universitetin POLIS, si nga sektori privat e ai publik.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Një nga pikat e evidentuara nga raporti i vlerësimit të jashtëm gjatë akreditimit fillestar të programit në 2013 ishte mungesa e një studimi të mirëfilltë tregu, edhe pse ka patur analiza të përgjithshme. Bazuar në këtë gjetje të raportit, dhe nga të dhënat e marra nga Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK), POLIS ka kryer një studim të mirëfilltë tregu për fushat e veta të interesit. Ky studim rikonfirmon nevojat e tregut të punës për ekspertë të fushës së dizajnit, dhe ky program studimi është hartuar në përputhje me nevojat e identifikuara nga ky studim.</p>
Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti POLIS me programin Bachelor në Art dhe Dizajn zhvillon këtë program si pjesë e 'industrive kreative' një instrument i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos në një kontekst si ai shqiptar ku mbizotërojnë bizneset e vogla dhe të mesme, dhe sektorë në rritje si turizmi.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
Standarti I.1 Kriteri 3, Kriteri 4, Kriteri 5, Kriteri 6, Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm,	

anekset që i bashkëngjiten këtij raporti, vizitës në institucion dhe verifikimit të dokumentacionit rezulton se Programi i studimit Bachelor në Art dhe Dizajn është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit në kuadër të përgatitjes së studentëve profesionalisht si specialist në fushën e Dizajnit me mundësi integrimi në një kontekst ndërdisiplinor pune si në sektorin e punësimit privat ashtu dhe publik.

Programi është hartuar për të përmbushur plotësuar nevojën në tregun e punës në përputhje edhe me nevojat e vendit si dhe mbështetur në eksperiencat ndërkombetare. Politikat dhe objektivat e programit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit në mënyrë që programi të mbështeti zhvillimin e vendit duke përgatitur studentë të aftë për të kontribuar në fushat e specializimit të tyre. Kjo bëhet e mundur edhe nëpërmjet respektimit të Axyhendës së Kërkimit Shkencor.

Ne lidhje me **Standarti I.2 Kriteri 1, Kriteri 2, Kriteri 3** Permbajtja e programeve të studimit është në përputhje me kriteret e percaktuara nga aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi, verifikohet dhe nga informacionet e marra në IAL dhe gjatë diskutimeve konsultimit me dokumentacionin përkatës. Emertimi i programit të studimit lidhet me nivelin e kualifikimit, sipas diskutimeve me stafin e IAL u informuam sekane marre të dhena nga tregu për mundësinë e punësimit të studentëve në nivel kombëtar. IAL raporton një numër gati konstant të studentëve në vite. Nisur nga të dhënat, nga bisedat me zyrën e marketimit, si dhe gjatë takimit me pedagogët e IAL, paraqitet se kjo program studimi është e kërkuar dhe ka interes në rritje si ka studentet të cilët aplikojnë në Universitetin POLIS, si nga sektori privat e ai publik.

Standarti II.1 Kriteri 1, Kriteri 2; Gjatë vizitës në Universitetin POLIS dhe nga verifikimi i kryer duket qarte se Universiteti POLIS me programin Bachelor në Art dhe Dizajn zhvillon këtë program si pjesë e 'industrive kreative' një instrument i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit, sidomos në një kontekst si ai shqiptar ku mbizotërojnë bizneset e vogla dhe të mesme, dhe sektorë në rritje si turizmi.

2. Struktura akademike e Fakultetit/Departamentit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma referencë: përbërësit e njësive dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësive, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Nga takimi me drejtuesit, u konstatua se pas hyrjes në fuqi të ligjit të Arsimit të lartë Nr. 80/15 dhe miratimit nga ministria e arsimit të statutit në fuqi të Universitetit POLIS, tashmë njësia përgjegjëse për organizimin e programit është Departamenti Art dhe Dizajn. (Më herët të gjithë programet organizoheshin në nivel Fakulteti).

Ky departament është një nga 3 njësitë bazë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Dizajnit dhe përbëhet nga staf akademik efektiv (PAE) dhe staf akademik me kontratë (PAK). Departamenti përmban staf vendas dhe të huaj.

Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn (FAD) ka në përbërje të tij 2 (dy) departamente përkatësisht: Departamenti Art dhe Dizajn dhe Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri si dhe 1 (një) Qendër Kërkimore: Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn

Fakulteti plotëson standartet e cilësisë sa i përket njësive bazë përberëse, numrit të stafit efektiv për çdo njësi bazë si dhe kualifikimin e tyre.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti Arkitekturë dhe Dizajn përbëhet nga tre Njësi bazë:

- Departamenti Art dhe Dizajn (9 PAE/11 PAK)
- Departamenti Arkitekturë dhe Inxhinieri (11 PAE/13 PAK)
- Qendra Kërkimore në Arkitekturë, Inxhinieri dhe Dizajn (9 PAE/0 PAK)

Të tre Njësitë bazë plotësojnë kërkesat ligjore për numrin minimal të anëtarëve (7 anëtarë) dhe 3 anëtarë me tituj/grada

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti Art dhe Dizajn është i përbërë nga 9 (nëntë) anëtarë personel akademik efektiv (PAE), dhe 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë personel akademik me kontratë (PAK), kurse sa i përket kualifikimit, 6 PAE kanë Tituj/Grada dhe 4 PAK kanë Tituj/Grada.

Në këtë kuptim departamenti plotëson standardet sa i përket numrit dhe kualifikimit të stafit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Përveç dokumentacionit në dispozicion në fillim të këtij vlerësimi, dokumentacione përkatëse të marrë në vizitat në institucion janë: (i) Statuti i Universitetit POLIS; (ii) Rregulloret didaktike; (iii) Raport vjetor i Njesise së Brendshme të Sigurimit të Cilesise; (iv) Dokumentimi sistemit të sigurimit të cilesise; (v) Raporti i Zyres së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) në U_POLIS; (vi) Raport për zhvillimet institucionale gjatë veprimtarisë 6 vjeçare të Universitetit POLIS; (vii) Organigrama e Stafuar; (viii) Shpenzimet sipas burimeve të financimit; (ix) Formular vlerësimi për pedagogun /asistent pedagogun; (x) Formular për vetëvlerësimin e pedagogut; (xi) Formular për vlerësimin e performancës së lektoreve në procesin mesimor; (xii) Syllabuset e lëndëve

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Nga të dhënat statistikore për stafin akademik dhe CV-të e tyre, GVJ gjykon se stafi i angazhuar në programin e studimit BSc në Art dhe Dizajn ka kualifikimin e dhe përvojën e duhur për të garantuar një mësimdhënie cilësore dhe për të transmetuar tek studentët njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për tregun e punës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabelat 3 në Aneks)

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi, BSc në Art dhe Dizajn ka një staf prej 25 anëtarë, nga të cilët 18 PAE dhe 7 PAK. Si rrjedhojë përqindja e pedagogëve me kohë të plotë kundrejt atyre me kontratë në vitin akademik 2018-2019 përbën 72% me 28%.

Nga analizimi i të dhënave për 6 vitet e fundit (Tabela, evidentohet se përqindja e Personelit Akademik Efektiv është mbi 70% e totalit, duke respektuar kështu standardin e kërkuar.

Respektivisht për secilin vit akademik:

Për vitin akademik 2013-2014, raporti PAE:PAK është 21:4 ose 84%:16%

Për vitin akademik 2014-2015, raporti PAE:PAK është 27:3 ose 90%:10%

Për vitin akademik 2015-2016, raporti PAE:PAK është 20:4 ose 83%:17%

Për vitin akademik 2016-2017, raporti PAE:PAK është 21:1 ose 95%:5%

Për vitin akademik 2017-2018, raporti PAE:PAK është 22:1 ose 96%:4%

Për vitin akademik 2018-2019, raporti PAE:PAK është 18:7 ose 72%:28%

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat 4)

Një element i cili evidentohet dhe nga vete institucioni është rritja e stafit me tituj akademik Prof. As dhe Prof. Dr.

Aktualisht janë vetëm 2 pedagogë me kohë të plotë me titullin Prof.Dr, dhe 1 pedagog me kohë të pjeshme me titullin Prof.Asoc, argumentuar kjo për arsye se “marrja e këtyre titujve në traditën e deritanishme shqiptare nuk ka qenë një praktikë e shpeshtë, për vetë natyrën aplikative të profesionit”. Ndërkohë, element shumë pozitiv është numri i lartë i stafit me gradën ‘Doktor’ të cilët parashikohen të pajisen me titujt pasues akademik, si dhe një numër stafi të rinjsh në rritje, që aktualisht ndjekin programet e Doktoratës.


Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në U_POLIS, këshillim për studentët, dhënie e ndihmës për studentët (këshillim akademik-tutorial) si dhe detyrat administrative në funksion të mësimdhënies. Në Departamentin e Art dhe Dizajnit në të cilin zhvillohet edhe programi Bachelor “Art dhe Dizajn”, ngarkesa e personelit akademik është në përputhje të plotë me parashikimet nënligjore për aktivitetet dhe standartet mësimore të personelit akademik në IAL, në varësi nga niveli i kualifikimit.

Të dhënat sipas moshës dhe Raportet midis tyre (Tabela 5)

Nga të dhënat e deklaruara nga Institucioni për stafin e angazhuar në programin e studimit BSc në Art dhe Dizajn vihet re që edhe në shpërndarjen moshore stafi i angazhuar ka një shpërndarje mjaft korrekte, ku vihet re se mbizotëron stafi i ri (që përbën 56% të totalit ose 14/25), por harmonizohet mjaft mirë me stafin me moshë mesatare por dhe atë me përvojë të gjatë akademike. Mbizotërimi i stafit të ri është i pritshëm për vetë faktin se dizajni përbën një disiplinë të re në kontestin shqiptar.

Të dhënat sipas seksit (Tabela 6 në aneks)

Raporti femra / meshkuj është 11/14 ose 44% me 56%, duke treguar kushtu ndjeshmërinë e institucionit për një balancë të mirë gjinore.



- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjate vizites ne institucionin perkates duket qarte se dhe rekrutimi i personelit akademik te profilit te propozuar vjen nga departamentet, te cilet parashtrojne ne terma reference te qarta duke percaktuar detyrat e personelit te kerkuar dhe profilin e tij. Detyrat e percaktuara ne termat e references bazohen ne permbajtjen e lendes qe do te ofrojë pedagogu, natyrën e mësimdhënies si dhe matricën e njohurive dhe aftësive të transferuara tek studentët. Përcaktimi i qartë i rolit të pedagogut mundëson dhe hartimin e profilit të tij, fushën e studimeve, gradat/titutjt akademikë, si dhe aktivitetin kërkimor që ai duhet të ketë.

Kontrata e punësimit të stafit, janë mbështetur në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për ngarkesën mësimore të pedagogut, si dhe perputhen me të Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit. Personeli akademik/mbështetës ndërton marrëdhënien e punësimit me institucionin në bazë të kontratës së punësimit. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe U_POLIS. Kontratat janë në përputhshmëri me kuadrin ligjor në fuqi dhe rregullativ të institucionit.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Gjate vizites ne U-Polis u informuam se për sa i përket procedurës së lidhjes së kontratës së punës, çdo anëtar i stafit administrativ dhe stafit akademik efektiv apo me apo me kohë të pjeshme ndiqet një procedurë e cila nis me procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes, informimit të personit për përzgjedhjen e tij për t'u marrë në punë pranë U_POLIS dhe më pas ai paraqitet dhe nënshkruan kontratën e punës e cila legalizon pozicionin e tij. Kontrata përfshin njohjen me detyrat dhe të drejtat e të dy palëve. Personit që rekrutohet i vihen në dispozicion të gjithë dokumentet e brendshme, statute, rregulloret dhe udhëzimet në mënyrë që ai të njihet në detaje me të drejtat dhe detyrimet e punës në institucion. Ndërkohë, elementët thelbësor të të drejtave dhe detyrimeve përfshihen në kontratën individuale që personi nënshkruan pasi njihet me to. (Aneks 12-RVB).

Synimi gjate perzgjedhjes është tërheqja e stafit kryesisht të huaj të kualifikuar me grada e tituj shkencor, eksperiencia në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.


Aktualisht U_POLIS ka plotësuar nevojat për staf të kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë duke punësuar profesionistë vendas dhe të huaj me përvojë në fushën akademike.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Pervec dokumentacionit ne dispozicion ne fillim te ketij vleresimi, dokumentacione perkatëse te marrë në vizitat në institucion jane: (i) Statuti i Universitetit POLIS; (ii) Rregullore didaktike; (iii) Raport vjetor i Njesise se Brendshme te Sigurimit te Cilesise; (iv) Dok sistemit te sigurimit te cilesise; (v) Raport i Zyres se Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës (ZMSKK) në U_POLIS; (vi) Raport per zhvillimet institucionale gjate veprimtarise 7 vjecare te Universitetit POLIS; (vii) Organigrama e Stafuar; (viii) Shpenzimet sipas burimeve të financimit; (ix) Formular vleresimi per pedagogun; (x) Formular per vetevleresimin e pedagogut; (xi) Formular per vleresimin e performances se lektoreve ne procesin mesimor; (xii) Formular vleresimi per asistent pedagogun.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore	Nisur nga vizita në IAL dhe verifikimin e dokumentacioneve dhe



dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.

nga diskutimet perkatëse rezultojnë se në statutin Rregulloren e Përgjithshme të IAL janë përcaktuar parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme gjithë që respektohet edhe në procedurat reale të rekrutimit të stafit.

Aktualisht, personeli akademik me kohë të plotë, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit "Bachelor ne Art dhe Dizajn" Aktualisht personeli akademik në këtë program studimi, Bsc në Art dhe Dizajn, është i përbërë nga 18 staf akademik me kohë të plotë dhe 7 staf me kohë të pjesshme. Si rrjedhojë raporti i pedagogëve me kohë të plotë kundrejt atyre me kontratë përbën 72 % të totalit. Institucioni kujdeset që stafi i ri të kalojë minimalisht një periudhë 3 vjeçare si asistent të stafit më me eksperiencë dhe më pas ai të jetë i pavarur.

Nga analizimi i të dhënave për 6 vitet e fundit, evidentohet se përqindja e Personelit Akademik Efektiv është mbi 70% e totalit, repektivisht sipas viteve akademike, PAE ka zënë përqindjet e mëposhtme:

Për vitin akademik 2013-2014 - 84%

Për vitin akademik 2014-2015 - 90%

Për vitin akademik 2015-2016 - 83%

Për vitin akademik 2016-2017 - 95%

Për vitin akademik 2017-2018 - 96%

Për vitin akademik 2018-2019 - 72%

Nisur nga shqyrtimi i Statutit (kreu XI), Rregulloren e Përgjithshme (kreu XV) si edhe në Rregulloren e NJBSC-së, si dhe nga vizita në IAL dhe Verifikimi i dokumentacioni, bisedat me stafin dhe me studentët rezultojnë që Vlerësimi i performancës së personelit akademik bazohet në procedurat e vendosura dhe saktësuara në Statut.


Vlerësimi i pedagogëve bëhet nga NJSBC përmes një metode që merr në konsideratë vlerësimin e studentëve, vlerësimin e kolegëve si dhe vetvlerësimin. Kjo procedurë realizohet përmes në qytësori në sistemin kompjuterik dhe është transparente.

Gjithashtu, rezultojnë se institucioni disponon të gjithë të dhënat mbi rekrutimin e personelit dhe shpall online në site-in e IAL njoftimet për vendet vakante.

Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit

Pas vizites dhe verifikimit të kryer në Institucionin perkatës i gjithë personeli akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, qofshin efektiv apo me kontratë të pjesshme, dispononin dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm të kërkuar



<p>të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor,, ose titullin akademik “Docent,,</p>	<p>nga Zyra Rajonale e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar si dhe materiale të tjera të kërkuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Nderkohe Institucioni disponon dhe një listë të plotë të stafit akademik të të gjithë institucionit, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.</p> <p>Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. Kriteret mbështeten kryesisht mbi Rregulloren e Përgjithshme të U_POLIS, kreu IV si dhe në procedurën e miratuar të rekrutimit të stafit. Kriteret publikohen në hapësira të ndryshme mediatike, si në faqen e internetit të institucionit dhe pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit.</p> <p>Nderkohe ne programin Bachelor Art dhe Dizajn titullarë të lëndëve/moduleve për programin e studimeve jane personel akademik që kane gradën shkencore “Doktor”.</p>
<p>Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Nga vizita në labororet e IAL dhe verifikimet mbi stafin akademik dhe administrativ u vu re që institucioni ka angazhuar personelit ndihmës për mirëpërdorimin e ambienteve laboratorike në mjediset universitare. Me plotësimin e një sërë laboratorësht Universiteti aktualisht ka 6 laboratorë në brëndësi të tij në shërbim të programit të studimit, ndër të cilat: Laboratori i Fotografisë, Laboratori Parametrik, Qendra MAD, MAC LAB të cilat influencojnë direkt procesin mësimor në këtë program.</p> <p>Aktualisht programi Bachelor në Art dhe Dizajn ka një raport jashtëzakonisht të mirë staf akademik/student në shkallën 1:5.7, raport që mundëson një punë intensive me secilin student individualisht.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.</p>	<p>Persa i perket angazhimit dhe kualifikimit te vazhdueshem te personelit, Universiteti POLIS, në varësi të specializimeve të ndryshme që stafi akademik ka, institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor: Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional”; “Master i Shkencave”, apo Programet e ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”.</p> <p>Gjithashtu, projektet ndërkombëtare dhe bashkëpunimet me Universitete jashtë vendit i ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Standarti III.1, Kriteri 1, Kriteri 2, Kriteri 3, Kriteri 4. Nga verifikimet e dokumentacioneve dhe nga diskutimet perkatese rezulton se në statutin Rregulloren e Përgjithshme të IAL janë përcaktuar parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme gjë që respektohet edhe në procedurat reale të rekrutimit të stafit.

Aktualisht, personeli akademik me kohë të plotë, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit "Bachelor ne Art dhe Dizajn" Aktualisht personeli akademik në këtë program studimi, Art dhe Dizajn, është i përbërë nga 18 staf akademik me kohë të plotë dhe 7 staf me kohë të pjesshme. Si rrjedhojë raporti i pedagogëve me kohë të plotë kundrejt atyre me kontratë përbën 72 % të totalit. Institucioni kujdeset që stafi i ri të kalojë minimalisht një periudhë 3 vjeçare si asistent të stafit më me ekperiencë dhe më pas ai të jetë i pavarur.

Nga analizimi i të dhënave për 6 vitet e fundit, evidentohet se përqindja e Personelit Akademik Efektiv është mbi 70% e totalit, duke respektuar kështu standardin e kërkuar

Nisur nga shqyrtimi i Statutit (kreu XI), Rregulloren e Përgjithshme (kreu XV) si edhe në Rregulloren e NJBSC-së, si dhe nga vizita në IAL dhe Verifikimi i dokumentacioni, bisedat me stafin dhe me studentët rezultojnë që Vlerësimi i performancës së personelit akademik bazohet në procedurat e vendosura dhe saktësuara në Statut.

Vlerësimi i pedagogëve bëhet nga NJSBC përmes një metode që merr në konsideratë vlerësimin e studentëve, vlerësimin e kolegëve si dhe vetvlerësimin. Kjo procedurë realizohet përmes në qytësori në sistemin kompjuterik dhe është transparente.

Gjithashtu, rezultojnë se institucioni disponon të gjithë të dhënat mbi rekrutimin e personelit dhe shpall online në site-in e IAL njoftimet për vendet vakante.

Standarti III.2, Kriteri 1, Kriteri 2, Kriteri 3, Kriteri 4; Pas vizites dhe verifikimit të kryer në Institucion perkates I gjithë personeli akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, qofshin efektiv apo me kontratë të pjesshme, dispononin dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm të kërkuar nga Zyra Rajonale e Punës, përfshirë këtu edhe CV individuale të detajuar si dhe materiale të tjera të kërkuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Juridike. Nderkohe Institucioni disponon dhe një listë të plotë të stafit akademik të të gjithë institucionit, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik. Nderkohe në programin Bachelor Art dhe Dizajn titullarë të lëndëve/moduleve për programin e studimeve janë personeli akademik që kanë gradën shkencore "Doktor".

Standarti III.3, Kriteri 1, Kriteri 2, Kriteri 3. Nga vizita në laboratorët e IAL dhe verifikimet mbi stafin akademik dhe administrativ u vu re që institucioni ka angazhuar personelit ndihmës për mirëpërdorimin e ambienteve laboratorike në mjediset universitare. Me plotësimin e një sërë laboratorësh të Universiteti aktualisht ka 6 laboratorë në brendësi të tij në shërbim të programit të studimit, ndër të cilat: Laboratori i Fotografisë, Laboratori Parametrik, Qendra MAD, MAC LAB të cilat influencojnë direkt procesin mësimor në këtë program.

Aktualisht programi Bachelor në Art dhe Dizajn ka një raport jashtëzakonisht të mirë staf akademik/student në shkallën 1:5.7, raport që mundëson një punë intensive me secilin student individualisht.

Standarti III.3, Kriteri 1, Kriteri 2. Në lidhje me angazhimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit, Universiteti POLIS Në varësi të specializimeve të ndryshme që stafi akademik ka institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor; Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional"; apo Programet e ciklit të tretë të studimeve "Doktoraturë". Gjithashtu, projektet ndërkombëtare dhe bashkëpunimet me Universitete jashtë

vendit i ofron personelit akademik dhe atij mësuesor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Pjesa përshkimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Universiteti POLIS ofron një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha disiplinat, duke ofruar mjedise të brendshme por dhe të jashtme të cilat mund të konsiderohen tepër cilësore dhe plotësojnë më së miri kushtet për studimi dhe punë të pavarur të studentëve.

GVJ vizitoi ambientet e universitetit si klasat, auditorët, laboratorët, sallat e studimit, bibliotekën por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta të studentëve të cilat përdoren për studentët. Të gjitha ambientet mund të konsiderohen bashkëkohore dhe që plotësojnë më së iri nevojat e studentëve. Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira të mjaftueshme për stafin akademik por dhe atë administrativ, të pajisur me infrastrukturë të përshtatshme për kryerjen e kërkimeve akademike, shkencore dhe të aplikuar.

Universiteti është e lidhur mirë me qytetin me 4 linja transporti publik njëra prej të cilave ofrohet falas nga U_POLIS dhe tjetra nga QTU.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset në funksion të programit të studimit janë paraqitur në Tabelën 7 dhe përbëhen nga:

Mjediset për Programin e studimit:

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyrë informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore

- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka e U_POLIS ka një fond aktual prej 10,000 titujsh në përputhje me programet që ofron.</p> <p>Biblioteka ka një literaturë të mjaftueshme por dhe të shumëllojshme e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime, për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore por dhe përgatitjen e tezave të U_POLIS.</p> <p>Nga vizita në bibliotekë u konstatua se ndodheshin periodikë të ndryshëm të shkruar por dhe elektronikë të revistave me influencë shkencore por jo vetëm.</p> <p>Drejtuari i fakultetit por dhe Përgjegjësi i Departamentit përgjegjës për këtë program studimi ishin shumë të angazhuar për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës. Kjo bëhej e mundur nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Buxhetit të Departamentit; ✓ Donacioneve nga partnere te ndryshem; ✓ Kontribute te projekteve EU (TEMPUS, Erasmus +) etj ✓ Publikime/përkthime nga vete stafi i U_POLIS. <p>Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve gjatë gjithë ditës, madje ofronte shërbim edhe ditëve të veçanta në fundjavë. Biblioteka ishte e pajisur me hapësirat e nevojshme për punë të pavarur.</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të</p>	<p>POLIS ka investuar dhe synon të vazhdojë në sigurimin e kushteve optimale infrastrukturore si edhe në teknologjinë bashkëkohore për të mundësuar mësimdhënie të një cilësie të lartë për të inkurajuar eksperimentimin dhe arritje të punëve kërkimore.</p> <p>U_POLIS aktualisht keto laboratorë në brendësi të tij në shërbim të programit të studimit:</p>

<p>programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Laboratori i CAD/SAP/ETABS/TEKLA 2. Laboratori i GIS 3. Sust_LAB 4. Laboratori i Mjedisit <p>Të gjithë këta laboratorë janë shumë të rëndësishëm për programin e studimit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës në institucion konfirmoi shume lehtë dhe qartë se infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin e programit është në përputhje me standardet e vendit dhe të BE-së. 2. Universiteti POLIS ka ofruar studentëve një ambient komod dhe të përshtatshëm për ndjekjen e aktivitetit akademik por edhe atij social. Në dispozicion të studentëve ka auditorë, klasa, sallë konferencash, mjedise të përbashkëta ku studentët mund të punojnë por dhe ambiente sociale ku mund të kalojnë kohën e tyre. Këtu mund të përmenden laboratorët dhe biblioteka. 	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Grupi i vlerësimit të jashtëm kontaktoi stafin përkatës dhe u konsultua me dokumente të shkruara për të verifikuar burimet e financimit dhe menaxhimit të tyre nga U_POLIS. Dhe në përfundim rezultoi se U_POLIS është financuar nga një sërë të ardhurash si: tarifat e studimit, donacione; projekte të përbashkëta me partnere, fonde publike dhe të tjera (Tabela 8 dhe 9, në Aneks).

Informacioni financiar i paraqitur më poshtë prezanton burimet e financimit ose të hyrat e universitetit sipas kategorisë: fonde publike, donacione dhe grande, tarifat e shkollimit, të ardhura të tjera projekte të përbashkëta etj në vlerë absolute dhe si % ndaj totalit të burimeve. Gjithashtu jep, përdorimin e burimeve financiare ose shpenzimet e kryera nga institucioni gjatë periudhës sipas kategorisë, paga, shpenzime dhe investime duke treguar edhe burimin e financimit të tyre. Raporti financiar vazhdon me llogaritjen e koston për student dhe me tej me ndarjen e përdorimeve sipas veprimtarive kryesore të institucioneve akademike që janë shpenzime për veprimtarinë akademike, shpenzime për kërkim shkencor dhe shpenzime për veprimtarinë e administrimit. Ndarja sipas kategorive të veprimtarive është bërë bazuar në angazhimet reale të stafit dhe shpenzimeve në tërësi duke marrë në konsideratë edhe udhëzimin e MAS mbi veprimtaritë e personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë.

Burimet e financimit. Gjatë 2 viteve të fundit Universiteti POLIS është financuar nga disa burime si: tarifat e studimit, donacione dhe grande, projekte të përbashkëta dhe të ardhura të tjera.

Në të ardhurat nga donacione dhe grande janë pasqyruar pjesa vjetore që i takon periudhës e grandeve në kuadër të projekteve Erasmus+ në të cilën Universiteti POLIS është partner, grande për realizimin e eventit *Tirana Architecture Week 2016* etj.

Në tarifatat e shkollimit përfshihen pagesat që bëjnë studentët gjatë vitit akademik përkatës për shërbimin arsimor.

Në të ardhura nga projekte të përbashkëta përfshihen përfitime direkte të Universitetit POLIS në kuadër të projekteve të përbashkëta me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë. Këto të ardhura nuk kanë hyrë në kontabilitetin dhe llogaritë e Universitetit dhe nuk janë administruar dhe taksuar në POLIS por nga partnerët me të cilët është zhvilluar projekti. Vetëm se në këtë rast përfitues i këtyre aktiviteteve ka qenë Universiteti POLIS. Vlera e këtij kontributi është një vlerësim duke marrë për bazë kostot e deklaruara të projektit. Këto fonde janë përfshirë në raport për të paraqitur një pamje të plotë të aktivitetit të Universitetit.

Të ardhura të tjera përfshijnë të ardhura nga aktivitete dytësore si angazhime në hartimin e planeve dhe projekteve të zhvillimit të territorit, konsulenca dhe ekspertiza profesionale, nënqera, zhvillim kurse dhe trajnime, zhvillim eventesh nga vetë institucioni dhe për të tretë etj.

Nga një analizë e burimeve të financimit shihet se përgjatë viteve është rritur pesha e burimeve të tjera të financimit duke realizuar synimin për diversifikimin e burimeve të financimit. Kështu sot të ardhurat nga këto burime janë kanë arritur në nivelin 23% të totalit. Kjo është reflektim i strategjisë financiare të universitetit për diversifikimin e burimeve të financimit, uljen e ekspozimit ndaj risqeve të financimit afatshkurtër me synim qëndrueshmëri financiare.

Rezulton se U_POLIS përdor burime financiare të diversifikuara dhe mbështet më tepër në mjete të tjera financiare si grand për projekte të përbashkëta sesa në tarifatat e studimit.

POLIS është ndër institucionet shqiptare që ka fituar rolin e partnerit lider në një program TEMPUS, duke mbajtur grandin prej 825,000 Euro, të siguruar nga Bashkimi Europian. Kjo tregon për besueshmërinë ndaj kapaciteteve të institucionit për menaxhimin e shumave të tilla. Ky projekt ka vijuar dhe me fitimin e shumë projekteve të tjera të Universitetit POLIS. Ku ka pas jo vetëm përfitime financiare por dhe shume mobilitete të stafit dhe studentëve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;</p> <p>Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Nga vizita u konstatua se monitorimi i aktiviteteve financiare kryhej rregullisht nga Bordi i Administrimit si dhe Asambleja e Ortakëve.</p> <p>Zyra e financës çdo vit hartonte bilancin vjetor. Për këtë qëllim ishte kontraktuar një kompani konsulencë financiare e cila asistonte Zyrën e Financave për probleme dhe aspekte financiare si dhe nëpërmjet një eksperti kontabël të autorizuar verifikonte dhe verifikonte bilancin vjetor të hartuar nga Zyra e Financave.</p> <p>Në përfundim të këtij procesi hartojë një raport ku GVJ u vu në dijeni.</p>
VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të	

studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë tëhollësisht financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton raporte vjetore financiare që përmbajnë të dhëna për aktivitetin financiar të tij.</p> <p>Këto raporte janë dhënë për të gjitha vitet akademike.</p> <p>Institucioni paraqet qëndrueshmëri financiare nga tarifat e studimit por edhe donacionet dhe bashkëpunimi me partner lokale dhe ndërkombëtarë.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Grupi i vlerësimit konstatoi se Universiteti POLIS ka një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare. Për më tepër hartohet një raport financiar në të cilin parashikohen kostot e programeve të studimit, të ardhurat dhe shpenzimet e tillë që të shërbejnë në një reflektim të drejtpërdrejtë në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë akademike. 2. Diversifikimi i të ardhurave financiare, rritja e zërave buxhetorë si fondet për pagat e stafit në rritje, për kërkimin shkencor në kuptimin e gjerë, përfshirë këtu edhe aktivitetet, botimet, anëtarësimet në rrjete ndërkombëtare apo investime, duke pas parasysh që rritja e kostos së shkollimit në disa raste të mos kompensohet me rritjen e tarifës, dëshmojnë për kujdesin e veçantë ndaj cilësisë dhe dimensionin e përgjegjshmërisë sociale. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njesisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në Raportin e vlerësimit të brendshëm grupi i vlerësimit shprehet:

Në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit POLIS, institucioni ka ngritur një njësi të qëndrueshme, strukturimi, përgjegjësitë dhe funksionimi i së cilës përcaktohet qartë në "Rregulloren e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë" miratuar me vendim të Senatit Akademik. Rregullorja shpreh qartë rëndësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë nëpërmjet së cilës garantohet cilësia gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive administrative dhe organizative të Universitetit POLIS.

NJBSC është një njësi e përhershme e pavarur, e cila nëpërmjet punës së saj në vlerësimin e cilësisë, synon krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në Universitetin POLIS. Njësia përbëhet nga 8 anëtarë (Tabela 10, Aneks), një ndër të cilët është përfaqësues i Studentëve dhe një përfaqësues i Alumni. Është organ me karakter të përhershëm, këshillimor dhe vlerësues dhe ka autonomi operative dhe qasje në të gjitha të dhënat e institucionit.

Parimet mbi te cilat është ndërtuar NJBSC:

1. Krijimi i një tabloje të qartë dhe reale rreth gjendjes aktuale të universitetit;
2. Ngritja e një sistemi efikas për sigurimin dhe krijimin e kulturës të cilësisë në institucion;
3. Garantimi i transparencës me qëllim informimin e të gjithë partnerëve dhe publikut të gjerë për performancën e POLIS, njësive, programeve, kurrikulave, shërbimeve etj.

Gjatë takimit me anëtarët e NJBSC u konstatua se kishte një ndarje të qartë të detyrave të anëtarëve të njësisë. Kjo ndikonte drejtpërdrejt me verifikimin dhe përmirësimin e cilësisë.

Këtu mund të përmendim se një nga anëtarët ishte i angazhuar vetëm për menaxhimin e procesit të vlerësimit të mësimdhënies, dikush tjetër monitorimin e procese administrative, kishte përfaqësues dhe përgjegjës për verifikimin e procesit kërkimor shkencor etj. Të gjitha këto të krijojnë një tablo sa më të qartë dhe më konkrete në fushën e cilësisë dhe përmirësimit të saj.

Objektivat e NJBSC janë:

- ✓ monitorimi i vazhdueshëm i institucionit;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij;
- ✓ ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion; ndjekja e ecurisë së bashkëpunimit të U_POLIS me institucione të tjera akademike, shkencore dhe jo akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- ✓ dhe monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të institucionit.

Duhet theksuar se në fund të çdo viti akademik të dhënat e procesit të vlerësimit grumbullohen dhe hartohen në formë Raporti Vjetor¹ i cili i paraqitet në formë zyrtare Rektoratit për t'ju vënë në dispozicion Senatit Akademik. Bazuar në të dhënat e raportit nxirren rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procesit të cilësisë dhe mësimdhënies dhe sigurohet që ato të zbatohen në çdo njësi të institucionit.

Dy vitet e fundit universiteti është duke u angazhuar në një projekt Erasmus+, Key Action 2, QainAL "Mbështetja strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri", për më shumë (<http://www.qainal.eu/page.aspx?id=1,2>).

Ky projekt ka për qëllim të krijojë dhe të mbështesë proceset për sigurimin e cilësisë dhe mekanizmat për të siguruar menaxhim efektiv dhe për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxëniet në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Projekti synon të mbështesë institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri për të arritur prioritetet e dy dokumenteve kryesore: "Rritja e ndikimit të Zhvillimit të BE-së: një Agjendën për Ndryshim" dhe "Arsimin e Lartë European në Botë". Projekti i drejtohet, prioritetit kombëtar për Projektin e Përbashkët, proceset e sigurimit të cilësisë dhe mekanizmave, nën kategorinë C - përmirësimin e menaxhimit dhe funksionimit të institucioneve të arsimit të lartë.

Gjithashtu u konstatua se të gjitha programet e ofruar pranë POLIS janë të akredituara, dhe vete POLIS si institucion është akredituar dhe ri-akredituar dy here.

Krahas këtyre vlerësimeve kombëtare POLIS, i është nënshkruar edhe procedurave të vlerësimit të cilësisë dhe të akreditimit sipas standardeve ndërkombëtare si vijon:

¹ Raportet Vjetore NJBSC, ndodhen të arkivuara në ambjentet e NJBSC.

1. Akreditim i përvitshëm nga autoritet përgjegjëse Italiane në kuadër të programit të përbashkët doktoraturë midis Universitetit POLIS dhe Universitetit Ferrara, duke filluar që nga viti akademik 2013-2014 dhe në vazhdim.
2. Përbushja e standardeve të cilësisë së Bashkimit Evropian dhe kërkesave të akreditimit në vendet e origjinës, IPAG Business School, Paris, Francë dhe IHS/ERASMUS University, Rotterdam, Netherlands në bashkëpunim më të cilat Universiteti POLIS ofron tre programe të studimi Master Profesional me nga tre profile secili.
3. Akreditim nga AESOP për programin e studimeve të integruara (5-vjeçare) Planifikim dhe Menaxhim Urban, data e lëshimit dhjetor 2015.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; c. Vlerësimi me nota/pikë; d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Etj. 	<p>POLIS ka pjesë strategjisë së tij përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies, dhe për këtë arsye mbi baza vjetore bëhet vlerësimi i ecurisë së programeve, nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve prej studentëve, mbarëvajtjes së procesit mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdoruara nga pedagogët, sugjerimeve prej pedagogëve të përfshirë në këtë program studimi etj.</p> <p>Aktiviteti i monitorimit organizohet nga NJBSC, për secilin nga proceset akademike/administrative që verifikimohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre raporton pranë rektoratit dhe dekanëve të fakulteteve.</p> <p>Nga këto verifikime hartohen raporte, janë prodhuar vlerësime, janë nxjerr rekomandime dhe janë lënë detyrë për rregullsinë e procesit mësimor, si dhe janë propozuar masa për ndryshime apo korrigjime për raste ose çështje konkrete.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit janë përdorur metoda të shumëllojshme të drejtpërdrejta ose të tërthorta. Këtu përfshihen sondazhet, pjesëmarrja në mbrojtjen e tezave, ndjekja e ecurisë së studenteve, punësimi, opinionin i tyre, rezultatet e mara nga studimi i tregut etj.</p> <p>Rezultatet e përfutur nga pyetësorët i bëhen të ditur stafit, studenteve administratës dhe më gjerë.</p> <p>Te dhënat bëhen pjesë e Raportit Vjetor që institucion dërgon në MASR dhe ASCAL.</p> <p>Nga GVJ iu kërkua Sekretarisë Mësimore dokumentacioni lidhur me vlerësimin e studenteve, metodat që përdoren për</p>

	<p>verifikimin e mësimnxënies.</p> <p>U njohëm me procesverbalet e studentëve, mënyrën e vlerësimit të pedagogëve për studentët, u konstatua se pjesëmarrja e studentëve ishte e detyrueshme.</p> <p>Me kënaqësi i konstatua se rezultatet e studentëve ishin të kënaqshme.</p>
--	---

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

POLIS i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm dhe ka fituar akreditimin periodik institucional për të tretën herë në vitin 2017 realizuar nga ASCAL dhe QAA.

Ky proces është realizuar pavarësisht një akreditimi në fuqi atij të fituar përmes Urdhrit Nr. 267, datë 20.05.2016 "Për Akreditimin Institucional të Universitetit "POLIS"

Kjo dëshmon qartë dëshirën e madhe të institucionit për përmirësimin e cilësisë së ofruar.

Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike hartohen përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në organet kolegjiale si Senati Akademik, Rektorat etj.

Në përdorimin e mekanizmave formalë për shqyrtimin dhe miratimin si dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të ofruara luajnë rol mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, organet e përhershme kolegjiale brenda fakulteteve si dhe këshillimi me specialist të fushës brenda ose jashtë institucionit.

Ndërgjegjësimi i personelit të U_POLIS mbi sigurimin e cilësisë për programet e ofruara në universitet lidhet drejtpërdrejt me vizionin që ka institucioni për të ofruar programe të një cilësie sa më të mirë. Ky proces starton me procedurat e punësimit të një anëtari të ri në stafin akademik, njohjen e tij me vlerat, misionin dhe vizionin e institucionit si dhe duke i kërkuar atij të bëhet pjesë e filozofisë së U_POLIS për të rritur cilësinë dhe për ta siguruar atë si vlerë sociale e kulturore.

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar takimin me anëtarët e NJBSC, stafin akademik si dhe në takimin me studentët u arrit në përfundimin se:

1. NJBSC (Njësia e Brendshme për sigurimin e Cilësisë) në POLIS ka një status institucional të mirëpërcaktuar si njësi permanente e mbështetur në anëtarë të brendshëm por dhe me përfaqësues nga studentët dhe nga ALUMNI, krijon një diversifikim dhe efikasitet në mënyrën se si operon në

përmirësimin e cilësisë.

2. Kjo njësi ka një rregullore mbi të cilën bazon aktivitetin e saj si një njësi me autonomi dhe përgjegjësi maksimale për të kryer aktivitetin e verifikimit, evidentuar problematikat dhe sugjeruar përmirësimet e nevojshme të cilat lidhen drejtpërdrejt me cilësinë.
3. Ajo ka për detyrë kryesore të monitorojë dhe raportojë në mënyrë të vazhdueshme rreth cilësisë së brendshme të institucionit.
4. Institucioni garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron. Për të realizuar këtë proces ka një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese.
5. Institucioni publikon rregullisht informacion te paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm. E gjithë veprimtaria e institucionit në lidhje me cilësinë përputhet me vizionin dhe udhëhiqet nga objektivat e strategjisë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Në lidhje me programin e studimit në Bachelor Art dhe Dizajn, institucioni ka të percaktuara mirë misionin dhe objektivat e programit të studimit, përmbajtja e programit, në rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur nga Departamenti i Art dhe Dizajn, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies) paraqiten dhe plotësojnë kriteret e duhura (Tabela 11, në Aneks).

Lendet pjesë e këtij programi disponojnë silabuset përkatëse ku parashtroheshin qarte elementet përberes se tyre. Elementi i cili duhet të permisohej janë pershtatja në formatin e ri të silabusit.

Qëllimi i Programit të Studimit Bachelor në Art dhe Dizajn është që të përgatisë studentët profesionalisht si Dizajner dhe Artist aplikativë, të cilët mund të kenë mundësi integrimi në një kontekst shumëdisiplinor pune, si në sektorin e punësimit privat, ashtu dhe publik. Ky program studimi i ciklit të parë i jep studentëve një formim me bazë të gjerë në fushën e artit; Artit Modern; Arteve Pamore si Piktura, Ilustrimi Grafik; Qeramika dhe Skulptura, e ato dixhitale për fushën e dizajnit si Fotografia; Artet Alternative dhe Konceptuale; Artet e Bazuara tek Kompjuteri; Dizajni Multimedial, etj. Kurrikula e programit synon të përgatisë ekspertë për tregun e punës në Shqipëri dhe atë ndërkombëtar

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi;

Sic parashtrohet dhe nga vete institucioni, qëllimi i programit të studimit Bachelor në Art dhe Dizajn është synon të përgatisë studentët profesionalisht si Dizajner dhe Artist aplikativë, të cilët mund të kenë mundësi integrimi në një kontekst shumëdisiplinor pune, si në sektorin e punësimit privat, ashtu dhe publik.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka **30** javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka **15** javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = **25** orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60'

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 11, në Aneks)

Programi i studimit i ciklit të parë i jep studentëve një formim me bazë të gjerë në fushën e artit; Artit Modern; Arteve Pamore si Piktura, Ilustrimi Grafik; Qeramika dhe Skulptura, e ato dixhitale për fushën e dizajnit si Fotografia; Artet Alternative dhe Konceptuale; Artet e Bazuara tek Kompjuteri; Dizajni Multimedial, etj. Kurrikula e programit synon të përgatisë ekspertë për tregun e punës në Shqipëri dhe atë ndërkombëtar. Programi i Studimit bachelor në Art e Dizajn, 3 vjeçar përmban 22 lëndë të organizuara në 35 module, të cilët përfshijnë internshipin profesional, si edhe temën dhe projekt diplomën. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Diplomë bachelor në Art dhe Dizajn nëse plotësojnë 180 kredite sipas sistemit ECTS. Kreditet janë të llogaritura sipas sistemit ECTS. Një krediti të formimit i korrespondon 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij.

GVJ e gjen kurrikulën të organizuar në përputhje me objektivat e programit dhe si përmbajtje (lëndët dhe modulet) por dhe p[esha specifike që secila lëndë zë në formimin e përgjithshëm që i ofrohet studentit.

Plani mësimor ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F), jepet në Tabelën 12, në Aneks.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- | | |
|------------------------------|--|
| ▪ Për leksionet | 8 - 12 orë në auditor dhe 13-17 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 6-18 orë në auditor dhe 17-19 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Labororet | 12 – 18 orë në auditor dhe 7-13 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 20 – 25 orë në auditor dhe 0-5 orë punë e pavarur e studentit |

GVJ e gjen këtë ndarje të përshtatshme për natyrën dhe nivelin e programit të studimit si dhe në përputhje me udhëzimet për këtë qëllim.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara

Ndryshimet në Planet mësimore nga 2013 deri me 2018 nuk e kalojnë me shumë se 20% të ndryshimit të programit. Ndryshimet në lende ndër vite janë si mëposhtë:

Lenda 1: Dizajn Industrial (ishte) u ndryshua me Teknologjia e Materialeve

Lenda 2: Fashion Dizajn i Avancuar (ishte) u ndryshua CAD dhe Artet e Bazuara tek Kompjuteri 3

Lenda 3: Shkrim, kritik arti dhe menaxhim arti (ishte) u ndryshua me Piktura II

Lenda 4: Package, branding dhe fashion design (ishte) dhe u ndryshua me Gjeometri Deskriptive.

GVJ i gjen këto ndryshime të mirëmbledhura dhe në funksion të përmirësimit të programit dhe aftësimit të studentëve për tu përgjigjur më mirë nevojave të tregut të punës.

Planet mësimoretë lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 13, në Aneks)

Nga te dhenat e paraqitura me planin mesimore ne lidhje me stafin e angazhuar në programin BSc në Art dhe Dizajn, ai përbëhet nga 18 pedagogë Personel Akademik Efektiv (me kohë të plotë) dhe 7 pedagogë Personel Akademik me Kontratë (staf me kohë të pjesëshme), nga të cilët për Personelin Akademik Efektive 2 me titull Prof., 6 me gradën shkencore Doktor, 7 kandidatë në doktoratë, dhe 3 me MSc. Personeli Akademik me Kontratë përbëhet me 1 titull Prof. Dr. (Akademik); 1 me titull Prof.Asoc.Dr; 1 me gradën shkencore Doktor dhe 1 me MND, dhe 3 me MSc. Raporti staf efektiv / staf me kontratë është 72 % /28%.

Nga 35 module që zhvillohen, 28 mbulohen nga personel akademik efektiv, 5 lëndë mbulohen nga pedagogë me kontratë. Drejtuesit e moduleve, në përgjithësi, kanë të paktën titullin Profesor. dhe gradën Shkencore Doktor, si dhe kualifikim Master Shkencor / MND. Ndër 18 pedagogët e brendshëm, 13 janë efektivë të FAD, 4 efektivë të IKZH, 1 efektivë të FPMMU, 6 të jashtëm me kontratë në FAD, 1 i jashtëm me kontratë në FPMMU.

Rreth 40% e stafit efektiv të këtij programi ka tituj e grada, ndërsa të tjerët janë në proces kualifikimi. Stafi i angazhuar që mbulon këtë program studimi janë staf i njësisë kryesore përgjegjëse për programin "Art dhe Dizajn" në (FAD), ndërkohë që angazhimi i stafit nga njësitë e tjera mbulon drejtime të përafërta me një sërë disiplinash të tjera që ofrohen në kuadrin e programeve të tjera të studimit të U_POLIS në të dy nivelet Bachelor dhe Master, duke garantuar një balancë të mirë mes specializimit, ndërdisiplinaritetit dhe kërkimit, gjë që është dhe në themel të filozofisë së U_POLIS.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset e depozituar si pjesë e DVV janë të gjitha të hartuar sipas të njëjtit format, i cili përmban të gjithë elementët e mësipërm.

Në përmbajtjen e tyre, syllabuset përcaktojnë qartë objektivat formues, të cilët janë në përputhje me objektivat e përgjithshëm të programit të studimit dhe nga analizimi i tyre dhe metodologjive të mësimdhënies vërehet fokusi tek thellimi teorik i studentëve por dhe aftësimi i tyre praktik. Të gjitha modulet trajtojnë tema bashkëkohore dhe relevante për formimin e studentëve. Metodologjitë e mësimdhënies janë gjithashtu të larmishme dhe në përputhje me objektivat e lëndës.

Gjatë vizitës në institucion, u konfirmua nëpërmjet takimit me stafin dhe studentët së syllabuset hartohen nga titullarët e lëndëve dhe më pas miratohen në departament e fakultet. Studentët njihen me syllabuset e lëndëve që në fillim të semestrit dhe mund ti konsultojnë ato në çdo kohë pasi janë të aksesueshme online në portalin e studentit në sistemin elektronik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi Bachelor në “Art dhe Dizajn” është në përputhje dhe në zbatim të strategjise, misionit dhe qëllimit të IAL. Ai ofron program mbështetur në ECTS me 180 kredite në tre vite, duke ruajtur një balancë të krediteve dhe ngarkesës mësimore ndër vite. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;</p> <p>Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.</p>	<p>Nga vizita e kryer në institucion rezultojnë se njësitë kryesore, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, hartojnë në fillim të çdo viti akademik planin mësimor të programit të studimit dhe japin të gjitha informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve, përfshirë informacionet e nevojshme për lëndët, për ngarkesën mësimore frekuentimin/ ndjekjen e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, materialet mësimore, oraret, datat e provimeve, objektivat e kurseve, sistemi i vlerësimit etj.</p> <p>Studenteve në fillim të vitit të parë të çdo programi studimi, çdo student i vihet në dispozicion Guida e U_Polis, po ashtu çdo pedagog në fillim të lëndës/moduli i një studentit me përmbajtjen; por janë dhe të aksesueshme online në faqen zyrtare të U_POLIS, pranë Sekretarisë Mësimore apo Bibliotekës ose Zyrës së Shërbimeve sipas tipit të materialit të kërkuar.</p> <p>Nderkohe nga takimi dhe materialet e vena në dispozicion rezultojnë se programi ka syllabuset e detajuara për çdo lëndë, gjithashtu të aksesueshme nga studentët në arkivën elektronike të shkollës, si dhe në portalin e çdo studenti.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Standarti I.1, Kriteri 1, Kriteri 2, Programi Bachelor në “Art dhe Dizajn” është në përputhje dhe në zbatim të strategjise, misionit dhe qëllimit të IAL. Ai ofron program mbështetur në ECTS me 180 kredite në tre vite, duke ruajtur një balancë të krediteve dhe ngarkesës mësimore ndër vite. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë</p>	

është 60 kredite.

Standarti II.4, Kriteri 1, Kriteri 2, Kriteri 3, Kriteri 4, Nga vizita e kryer ne institucion rezulton se njësitet kryesore, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, hartojnë në fillim të çdo viti akademik planin mësimor të programit të studimit dhe japin të gjitha informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve, përfshirë informacionet e nevojshme për lëndët, për ngarkesën mësimore frekuentimin/ ndjekjen e programmi, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, materialet mësimore, oraret, datat e provimeve, objektivat e kurseve, sistemi i vlerësimit etj.

Studenteve në fillim të vitit të parë të çdo programi studimi, çdo studenti i vihet në dispozicion Guida e U_Polis, po ashtu çdo pedagog në fillim të lëndës/moduli i njeh studentët me përmbajtjen; por janë dhe të aksesueshme online në faqen zyrtare të U_POLIS, pranë Sekretarisë Mësimore apo Bibliotekës ose Zyrës së Shërbimeve sipas tipit të materialit të kërkuar.

Nderkohe nga takimi dhe materialet e vena ne dispozicion rezulton se programi ka syllabuset e detajuara për çdo lëndë, gjithashtu të aksesueshme nga studentët në arkivën elektronike të shkollës, si dhe në portalin e çdo studenti.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, verifikimi i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënjes bëhet përmes oreve të leksionit, seminarëve, orëve studio, praktikave mësimore dhe pune laboratorike. Me pajisjen e Universitetit me Laboratorë një pjese e oreve të praktikës zhvillohen edhe si pune laboratorike qe per shkak te profilit të studimeve konsiderohen dhe si orë pune në studio.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet janë (Tabela 14):

- Leksione
- Seminare
- Studio
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale

Format e verifikimit të njohurive

Tabela 15 në aneks pasqyron raportet sipas komponentëve të vlerësimit gjithë-vjetor të studentit. Vlerësimi gjithëvjetor është një komponent i rëndësishëm pasi vë studentin në punë gjatë gjithë vitit duke bërë që procesi i mësimdhënies dhe mësimnxënies të jetë më efektiv. Kombinimi i tij medetyra kursi, projekte, si dhe natyra e programit dhe diplomës, bën të mundur vlerësimin në të gjithë mozaikun e formimit të studentit dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.

Vlerësimi final ndërtohet gjatë gjithë semestrit / vitit dhe është rezultat i ponderuar i disa elementëve, pesha e të cilëve varion në përputhje me natyrën e lëndës. Lëndët e formimit bazë dhe ato teorike i caktojnë një peshë më të lartë provimit ose testeve teorike, ndërkohë që lëndët karakterizuese ose laboratorët, projekteve dhe detyrave

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj, (Tabela 16, ne Aneks)

Studentët e këtij programi angazhohen në forma dhe mënyra të ndryshme në projekte e veprimtari kërkimore shkencore në të gjitha nivelet. Duke qënë një program studimi mjaft aplikativ, kërkimi shkencor i cili organizohet nga Departamenti i Art dhe Dizajnit konsiston në ndërthurjen e tematikave të ndryshme që organizohen gjatë procesit mësimor si ekspozita apo prezantim projekti, konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të “Tirana Design Week” dhe “Tirana Architecture Week”, si dhe shumë aktiviteteve të tjera të cilat organizohen sëbashku me partner lokal dhe ndërkombëtar si “Young Ballkan Designers”; “Fluid Design Week”; “Skopje Design Week”; “Mikser Festival” dhe shumë të tjera të cilat zhvillohen në rajon.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Dokumentacioni përkatës është pjesë e anekseve bashkangjitur këtij raporti

9. Studentët

Pjesa përshkimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Ky program studimi synon që ti ofrojë studentit një nivel të lartë formimi e edukimi, në përshtatje me kërkesat e reja të tregut, si dhe ndikojë në formimin e studentit që të jetë një profesionist i denjë. Nga vizita e kryer ne Universitetin POLIS, rezultoi se vete universiteti ruan në database e tij të gjithë studenët e diplomuar në POLIS. Nëpërmjet takimeve shoqërore, kontakteve të ndryshme, marrëdhënia e studentëve me universitetin vazhdon përtej jetës shkollore të përfunduar. Universiteti kërkon të ruajë me ta një marrëdhënie të gjatë, që i shoqëron ata gjatë jetës së tyre profesionale, duke i angazhuar atënë takime vjetore të Alumni, Forumet e hapura për shkëmbim eksperience, “Polis GotTalent”, etj


Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Kriteret e pranimit të studentëve në programin Bachelor në Art dhe Dizajn

Lejohen që të ndjekin studimet në këtë Program Bachelor ata kandidatë që:

8.1 Kanë fituar diplome sipas pikës 6.1 ose ekuivalente me to, sipas akteve në fuqi, dhe kanë mesatare të ponderuar të notave të studimit kundrejt pikëve maksimale sipas kriterëve të përcaktuara nga U_POLIS.



- 8.2 Janë fitues në konkurimin midis kandidatëve aplikantë brenda kuotave të pranimit të paracaktuara çdo vit nga universiteti, të cilat shpallen në mjediset e dukshme të universitetit dhe në website-in e shkollës në internet, jo më vonë se 1 javë para fillimit të studimeve.
- 8.3 Pranoen në këtë Bachelor në bazë të konkurimit/klasifikimit brenda numrit të miratuar tëkuotave, referuar një procesi përzgjedhës që bazohet tek merita e profesionalizimi, dhe të shpallur në websitin e U_POLIS. Mosregjistrimi ose mosdorëzimi i dokumentacionit të kërkuar në afatin e paracaktuar nënkupton skualifikimin. Në këtë rast ose në rast tërheqje të kandidateve të kualifikuar, përfiton kandidati i parë në listën pritëse.
- 8.4 Kryejnë me sukses studimet brenda afatit kohor të përcaktuar nga universiteti.
- 8.5 Studentët e regjistruar në programin në fjalë Bachelor të U_POLIS nuk mund të jenë ose të regjistrohen më pas njëkohësisht në programe të tjera Bachelor.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve, nota mesatare (Tabela 17, në Aneks)

Nga të dhënat e tabelës 17 në aneks vihet re një mesatare e mirë në hyrje për këtë program studimi. Duke marrë në konsideratë numrin në rritje të studentëve hyrës në këtë program cilësia e tyre e vënë re kjo nga mesatarja është konstante e një cilësie mbi mesataren.

Studentë e diplomuar, punësimi i tyre (Tabela 18, në anekse)

Rreth 95% e studentëve janë të punësuar pas diplomimit. Shumë prej tyre janë aktivë në sektorin publik, privat ose me vetëpunësim kreativ. Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës ka bërë një studim më të hollësishëm mbi nivelin e punësimit, natyrën dhe përputhshmërinë e punësimit me formimin e përgjithshëm dhe specifik të çdo studenti duke i ndjekur e mbajtur kontakte me ta edhe pas diplomimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr.80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në fuqi. Në përgjithësi U_POLIS ka një procedurë të qartë pranimi dhe seleksionimi të kandidatëve nëpërmjet testeve specifike për programet e ndryshme të studimit. Programi Bachelor në Art dhe Dizajn ka një test pranimi në bazë të konkurimit/klasifikimit brenda numrit të miratuar të kuotave, referuar një procesi përzgjedhës që bazohet tek merita. Ky proces konsiston një test me shkrim që bazohet në njohuritë e fituara në shkollën e mesme, kulturën e përgjithshme dhe njohuritë në fushën e mbuluar nga programi i studimit si dhe mesatarja e notës së fituar gjatë shkollës së mesme.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin</p>	<p>Informacioni i përgjithshëm mbi strukturën institucionale,</p>

<p>dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;</p> <p>Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.</p>	<p>ofertën akademike, rezultatet e të nxënit dhe orientimit në tregun e punës, studentëve u jepet me anë të Guidës së Studentit e cila përditësohet vit pas viti. Në këtë dokument përfshihen detaje të kurrikulës akademike, kritereve dhe kushteve që studentët duhet të plotësojnë, kushtet për kalimin nga një vit në tjetrin, etj. Kriteret e përcaktuara në zbatim të këtij standarti përmbushen edhe përmes ngritjes, funksionimit dhe veprimtarisë së Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës në U_POLIS.</p> <p>Nga intervistat e kryera me studentet si dhe njesite baze, rezultojnë se vlerësimi i padagogut kryhet.</p>
<p>Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.</p>	<p>Nga vizita dhe verifikimi në Sekretarinë mësimore të IAL rezultojnë se çdo student kadosjen personale. Gjithashtu informacioni për çdo program studimi, është i ruajtur në hard copy dhe në mënyrë elektronike.</p> <p>Database elektronik është i ruajtur dhe i siguar sipas elementëve të sigurisë nëpërmjet sistemit të backup.</p> <p>Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, rregjistrimet e tyre si dhe diplomimin. Këto statistika dërgohen në drejtorinë e Statistikave në MAS, njëkohësisht edhe Departamentit përkatës, i cili është përgjegjës për programin e studimit.</p> <p>Vlerësimet/notat e studentëve ruhen elektronikisht (regjistri elektronik i notave), njëkohësisht plotësohet edhe regjistri fizik i notave.</p>
<p>Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Për këshillimin e studentëve janë caktuar persona përgjegjës lidhur për ecurinë e procesit akademik dhe përmes shërbimit të tutoratit që zakonisht e ofrojnë menaxherët e kurrikulës.</p> <p>Mundësinë për kryerjen e praktikës profesionale, IAL e ofron nëpërmjet dy partnerëve të vet strategjikë Co-PLAN e Metro_POLIS, por dhe nëpërmjet rrjetit të partnerëve.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Standarti IV.1, Kriteri 1, Kriteri 2. Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr.80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në fuqi. Pas vizites se kryer ne Universitetin POLIS rezultojnë se ka një procedurë të qartë pranimi dhe seleksionimi të kandidatëve nëpërmjet testeve specifike për programet e ndryshme të studimit. Programi Bachelor në Art dhe Dizajn ka një test pranimi në bazë të konkurimit/klasifikimit brenda numrit të miratuar të kuotave, referuar një procesi përzgjedhës që bazohet</p>	

tek merita. Ky proces konsiston një test me shkrim që bazohet në njohuritë e fituara në shkollën e mesme, kulturën e përgjithshme dhe njohuritë në fushën e mbuluar nga programi i studimit si dhe mesatarja e notës së fituar gjatë shkollës së mesme.

Standarti IV.2, Kriteri 1, Kriteri 2, Kriteri 3, Kriteri 4. Universiteti POLIS ofron Informacion te përgjithshëm mbi strukturën institucionale, ofertën akademike, rezultatet e të nxëniet dhe orientimit në tregun e punës, studentëve u jepet me anë të Guidës së Studentit e cila përditësohet vit pas viti. Në këtë dokument përfshihen detaje të kurrikulës akademike, kritereve dhe kushteve që studentët duhet të plotësojnë, kushtet për kalimin nga një vit në tjetrin, etj. Kriteret e përcaktuara në zbatim të këtij standarti përmbushen edhe përmes ngritjes, funksionimit dhe veprimtarisë së Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës në U_POLIS. Nga intervistat e kryera me studentet si dhe njesite baze, rezulton se vleresimi I pedagogut kryhet.

Standarti IV.3, Kriteri 1, Kriteri 2, Kriteri 3, Nga vizita dhe verifikimi në Sekretarinë mësimore të IAL rezulton se cdo student kadosjen personale. Gjithashtu informacioni për çdo program studimi, është i ruajtur në hard copy dhe në mënyrë elektronike. Database elektronik është i ruajtur dhe i siguruar sipas elementëve të sigurisë nëpërmjet sistemit të backup. Sekretaria mësimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me regjistrimet e studentëve, transferimet, çregjistrimet e tyre si dhe diplomimin. Këto statistika dërgohen në drejtorinë e Statistikave në MAS, njëkohësisht edhe Departamentit përkatës, i cili është përgjegjës për programin e studimit.

Vlerësimet/notat e studentëve ruhen elektronikisht (regjistri elektronik i notave), njëkohësisht plotësohet edhe regjistri fizik i notave.

Standarti IV.3, Kriteri 1, Kriteri 2, Kriteri 3 Per këshillimin e studentëve janë caktuar persona përgjegjës lidhur për ecurinë e procesit akademik dhe përmes shërbimit të tutoratit që zakonisht e ofrojnë menaxherët e kurrikulës.

Mundësinë për kryerjen e praktikës profesionale, IAL e ofron nëpërmjet dy partnerëve të vet strategjikë Co-PLAN e Metro_POLIS, por dhe nëpërmjet rrjetit të partnerëve.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor vlerësohet të luaj rol të rëndësishëm në Universitetin POLIS. Institucioni harton në mënyrë periodike Axhendën e Kërkimit Shkencor ku duke ndjekur Strategjinë e Zhvillimit, detajohen fushat e interesit të kërkimit shkencor të institucionit, sipas fakulteteve dhe departamenteve. Ky dokument shërbes si bazë për politikat e kërkimit shkencor në institucion. Universiteti POLIS nxit dhe mbështet kërkimin shkencor të personelit akademik nëpërmjet programeve të brendëshme, programeve të përbashkëta, projekteve ndërkombëtare dhe financimeve direkte. Rezultatet e kërkimit shkencor vlerësohen nga institucioni, shpërndahen nëpërmjet publikimeve dhe shërbejnë për rritjen e kapacitetit në vend, për zhvillimin e inovacionit në industri dhe për përditësimin e përmirësimin e mësimdhënies.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 19, në aneks)

Bazuar në deklarinimin e institucionit si dhe në verifikimet e kryera gjatë vizitës në institucion rezultoi se institucioni është shumë i perkushtuar ndaj kërkimit shkencor në të gjitha nivelet, stafi individualisht, departamentet por dhe në nivel ndër-departmental siç na u shpjegua gjatë takimit me Innovation Factory.

Kërkimi shkencor dhe ai i aplikuar kryhet nëpërmjet një morie aktivitetesh si konferenca, simpoziume, seminare, projekte kërkimore, publikime, etj.

Është për tu theksuar dimensionin ndërkombëtar të kërkimit (programi i doktoratës, organizmi i konferencave ndërkombëtare, publikime ndërkombëtare dhe në gjuhë të huaj, etj)

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Bazuar në RVB dhe analizën SWOT të vetë U_POLIS, bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar evidentohet si një pikë e fortë e institucionit në tërësi por dhe e programit konkretisht.

Sasia dhe larmia e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizma publikë dhe privatë, universitete vendase dhe të huaja ka mundësuar që U_POLIS të ketë një portfolio të pasur me aktivitete të kryera në bashkëpunim me institucione partnere.


Në mënyrë të veçantë evidentohen projektet kërkimore dhe për ngritjen e kapaciteteve (multilaterale dhe bilaterale) të financuara nga BE. Janë 14 projekte të tilla në të cilat, U_POLIS është aktualisht i përfshirë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor dhe projektet Bi/Multilaterale ku U_POLIS është partner ose drejtues jepet në tabelat 19 dhe 20.

Gjithashtu vazhdon implementimi i disa projekteve të tjera si:

1. Projekti Horizon 2020/ «Kultura e trafikut të sigurt dhe qasja drejt sistemeve të sigurta nëpërmjet ndryshimit në kulturën e kërkimit dhe inovacionit/Tra Sa Cu»
2. Projekti COSTCA 16114 «Rikonceptimi i qëndrueshmërisë nëpërmjet ekonomive regjenerative» (RESTORE)
3. Future Architecture Platform – Projekt i financuar nga programi i BE «EvropaKreative»
4. Erasmus KA1 Program Shkëmbimi për staf dhe studentë mes Universitetit POLIS dhe Universitetit të Minho-s Portugali
5. Erasmus KA 1 Program Shkëmbimi për staf dhe studentë mes Universitetit POLIS dhe Universitetit Politeknik të Barit, Itali;
6. Erasmus KA 1 Program Shkëmbimi për staf dhe studentë mes Universitetit POLIS dhe Universitetit të Molise,



Itali;

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:
- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
 - Organizatat Profesionale
 - Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Bazuar në RVB dhe analizën SWOT të vetë U_POLIS, kjo evidentohet si një pikë e fortë e institucionit në tërësi por dhe e programit konkretisht.

Sasia dhe larmia e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizma publikë dhe privatë, universitete vendase dhe të huaja ka mundësuar që U_POLIS të këtë një portfolio të pasur me aktivitete të kryera në bashkëpunim me institucione partnere.

Në mënyrë të veçantë evidentohen projektet kërkimore dhe për ngritjen e kapaciteteve (multilaterale dhe bilaterale) të financuara nga BE. Janë 14 projekte të tilla në të cilat, U_POLIS është aktualisht i përfshirë.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me komunitetin e biznesit janë gjithashtu shumë të vlefshme jo vetëm për praktikën profesionale të studentëve por dhe për të marrë vazhdimisht feedback nga tregu i punës.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Marrëveshjet e Bashkëpunimit
 - Statistika për projektet
 - Inspektim fizik i laboratorëve

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	Bazuar ne dokumentacionin vene ne dispozicionin Universiteti POLIS ka nje sere marreveshjesh efektive te cilat deshmojne marredhenie bashkepunimi me ndermarrje apo siper marrje nga fusha te tregetise, industrise apo sherbimeve prodhuese. Marreveshje bashkepunimi jane lidhur si me organizma publike ashtu dhe private, si psh TICAB ose Young Balkan Desigeners, ose biznese të ndeyshme ku studentët kryejnë praktikat mësimore si AKZ Creative Studio, FM Reklama.
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me	Universiteti POLIS disponon nje numer te konsiderueshem Marreveshjesh Bashkepunimi me Universitete homologe te

institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

rajonit, evropiane dhe me tej, gje që i mundeson stafit por edhe studenteve të jene pjese e mobiliteteve, trajnimeve, pjesemarrjes ne Konferenca dhe evente te rendesishme nderkombetare

Vete organizimi i masterave profesionale ne bashkepunim me Universitete evropiane apo dhe programi i perbashket i doktoratures, e ben me te prekshem bashkepunimin dhe perfitimin ne terma reale.

Nderkohe Universiteti POLIS bashkëpunon ngushte me komunitetin e biznesit si dhe institucionet publike për organizimin e seancave dëgjimore, konferenca apo trajnime të përbashkëta.

Nga lista e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, depozituar nga Universiteti në kuader të RVB, janë perzgjedhur në mënyrë rastesore disa prej tyre, ku vihet re realizimi dhe përdorimi efektiv që vjen nga këto marrëveshje, qoftë përsa i përket intershipit të studenteve, mobiliteteve apo pjesemarrjes së paleve në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Universiteti POLIS.

Kryesisht koordinimi i kërkimit kryhet në nivel departamenti, ku sic na u shpjegua stafi në një ëorkshop të përvitshëm harton në mënyrë kolegjiale Axhendën Kërkimore, e cila më pas përkthehet në një plan individual që i bashkëngjitet kontratës. Në përfundim të vitit akademik stafi raporton në departament për realizueshmërinë e planit kërkimor, për të cilin dhe vlerësohet nga NJSBC.

Institucioni garanton edhe marrëdhënie bashkëpunimi mes personelit të tij. Gjate takimeve u vu re, se stafi është i prirur të shkëmbejë ide dhe mendime për punë dhe projekte kërkimore, të ndaje të reja në fusha me interes të përbashkët, madje krahas takimeve të percaktuara në kalendarin vjetor të Universitetit, kjo frymë bashkëpunimi tashmë ndjehej natyrshëm si pjesë e akitivititit të përditshëm të stafit.


Në rastë projektesh ndërdisiplinore, njësi përgjegjëse për koordinimin ishte Innovation Factory.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Universiteti POLIS ka një sërë marrëveshjes të cilat dëshmojnë marrëdhënie bashkëpunimi me ndermarrje apo sipermarrje nga fusha të tregëtisë, industrisë apo shërbimeve prodhuese. Ky bashkëpunim i ndërsjellë u mundëson studenteve praktika/ intership cilesor duke u mundësuar atyre që njohuritë teorike të integrojnë me botën reale të tregut të punës. Universiteti në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit, nëpërmjet këtyre marrëveshjeve ka ditur të verë në shërbim të objektivave të vendosura dhe të përgadise me se miri studentet për sfidat por dhe risitë e tregut të punës
2. Frymë mjaft pozitive mes personelit, është një nga pikat e forta të Universitetit POLIS, gje që reflektohet në nisur të përbashkëta të personelit në projekte kërkimore, botime, Konferenca shkencore por dhe për

nje jete te shendetshme sociale

3. Universiteti POLIS bashkepunon intensivisht me institucione homologe te rajonit, evropiane por dhe me tej, dhe kjo i mundeson stafit por edhe studenteve te jene pjese e mobiliteteve, trajnimeve, pjesemarrjes ne Konferenca dhe evente te rendesishme nderkombetare. Nga ana tjeter nje qasje e tille e strategjise se nderkombetarizimit natyrshem e pozicion Universitetin POLIS ne harten e Universiteteve me ne ze evropiane.



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Për këtë program studimi, akreditimi fillestar kishte lënë vetëm një rekomandim që i referohej forcimit të mëtejshëm të lidhjes së programit me tregun e punës.

Mbështetur në RVB, dokumentacionin mbështetës dhe vizitën në institucion, sidomos takimi me Zyrën e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, gjykojmë së ky rekomandim është përmbushur plotësisht.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Programi i studimit BSc Art dhe Dizajn është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe adreson nevojat e tregut të punës. Programi është i hartuar në përputhje me nivelin e studimit dhe ka objektiva formimi të mirëartikulluar.
2. Që prej akreditimit fillestar në 2011, programi tregon se ka arritur qëndrueshmëri dhe është tashmë një program i konsoliduar.
3. Krahasimisht me akreditimin fillestar vihet re një rritje në numrin e studentëve të regjistruar dhe përmirësim i cilësisë në hyrje.
4. Një aspekt tjetër që ka pësuar përmirësim dhe rritje sasiore e cilësore janë laboratorët dhe biblioteka dhe materialet studimore në shërbim të programit të studimit.
5. U_POLIS ka tashmë një sistem të ngritur e funksional të sigurimit të brendshëm të cilësië, por dhe një përvojë shumë të mirë me procese të jashtme të vlerësimit të cilësisë fituar nëpërmjet akreditimit institucional (me vlerësim shumë të lartë dhe nga procesi i fundit kryer nga QAA dhe ASCAL), por dhe me akreditim ndërkombëtar për disa nga programet e studimit.
6. Një nga aspektet pozitive të konstatuara (e vlerësuar dhe nga vetë studentët) ishin metodat e larmishme të mësimdhënies dhe pajisja e studnetëve jo vetëm me njohuri teorike por dhe aftësi praktike e aplikative.
7. U_POLIS ka dëshmuar një përkushtim të qartë ndaj kërkimit shkencor, reflektuar kjo në portfolion e pasur të projekteve dhe aktiviteteve kërkimore, ku krahas stafit, angazhohen sipas rastit dhe studentët.
8. U_POLIS ka ndërtuar një rrjet të gjërë partnerësh kombëtare e ndërkombëtarë që mundëson jo vetëm një burim informacioni për përmirësimin e kurrikulës, por dhe organizimin e një sërë aktiviteteve të projektsh, si dhe praktika mësimore e internship për studentët. Shkalla e ndërkombëtarizimit është shumë e lartë si në nivel institucional por dhe programor, reflektuar kjo në përmbajtjen e kurrikulës, stafin ndërkombëtar të angazhuar dhe numrin në rritje të mobilitetit të stafit dhe studnetëve.
9. Një nga treguesit më pozitivë është numri i lartë i të punësuarve nga të diplomuarit e programit BSc Art dhe Dizajn (95%). Ky indikator është një konfirmim më shumë për cilësinë e programit por dhe rezultat i mbështetjes së vazhdueshme ofruar studentëve jo vetëm gjatë studimeve por dhe në momentin e integritit të tyre në tregun e punës.

b. Pika për përmirësim:

1. Inkurajohet institucioni që të vazhdojë të investojë që kapacitetet e laboratorëve pranë IAL të vazhdojnë rriten duke ju mundësuar studentëve të marrin kompetenca sa më reale me kërkesat aktuale në tregun e punës. Ky është në fakt dhe objektiv i vetë IAL.

c. Mundësitë:

1. Kërkesë në rritje për këtë lloj profesioni, në vend dhe në rajon, e konfirmuar dhe nga studimi i tregut.
2. Investimet në laboratorë, dhe projektet e ndryshme kërkimore në bashkëpunim me institucione partnere vendase dhe ndërkombëtare, do sjellim rritje të mëtejshme të cilësisë së programit falë ngritjes së kapaciteteve humane dhe infrastrukturore.

d. Pengesat:

1. Rënia demografike dhe ulja e numrit të aplikantëve për të vazhduar studimet e larta në Shqipëri në tërësi, mund të afektojë dhe numrin e të regjistruarve në këtë program, megjithëse treguesit e deritanishëm tregojnë një rritje të qëndrueshme.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm



Dr. Gjergj Thomai

Dr. Elvan Dajko

